



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:067692

Datë: 15.05.2019

Numri i dokumentit: 00313141

**P. nr.814/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.1188/18 të datës 09.11.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **06.05.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit N. K., të dëmtuarit M. B. dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa përpiloi me datë 14.05.2019 këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **S. K.** nga Gjakova, Rr ”. . .” nr. . . , data e lindjes . . . në Gjakovë, i biri i Sh. dhe i nënës B. e gjinisë Sh., ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, i martuar atë i 2 fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me ID . . .

### **Ë s h t ë f a j t o r :**

#### **Sepse:**

**- me datë 01.08.2018**, rreth orës **23:30 min**, në Gjakovë, respektivisht tek restorant ”. . .”, i shkaktonte lëndime trupore të dëmtuarit M. B., në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje lidhur me një porosi në restorantin e cekur më lartë, ku i dëmtuari ishte duke shërbyer, i pandehuri pas fjalosjes verbale, duke dalur nga restoranti e godet të dëmtuarin me grusht në veshin e majtë dhe në krahun e djathtë, ku si pasojë e goditjeve i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuar sipas ekspertizës mjekoligjore të Dr. B. C. të datës 31.10.2018.

**-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 të KPRK-së .**

Gjykata në bazë të nenit 4, 17, 41, 49,50,51,52 ,73 të KPRK-së dhe nenit 188 par.1-1.4 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së i shqipton :

### **DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 4 ( katër ) muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari M. B. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej **20.00 €** (në emër të ekspertizës mjeko-ligjore) si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20.00 euro**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP.nr.1188/18 të datës 09.11.2018, kundër të akuzuarit S. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 30.11.2018, Prokurori i shtetit N. K. lexoi aktakuzën PP.nr.1188/18 të datës 09.11.2018, me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari S. K., gjatë shqyrtimit fillestarë duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer të cilën vepër e kam kryer në afekt , kërkoj falje nga i dëmtuari për lëndimet e shkaktuara , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm ,gjendjen e dobët ekonomike , si dhe faktin se është hera e parë që kam rënë me ligjin ,të më shqiptojë një dënim me të butë .

I dëmtuari M. B. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi

Duke deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit N. K. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorin juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme nga të cilat formohen të gjitha elementet e veprave penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari S. K. : me datë 01.08.2018, rreth orës 23:30 min, në Gjakovë, respektivisht tek restorant ”. . .”, i shkaktonte lëndime trupore të dëmtuarit M. B., në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje lidhur me një porosi në restorantin e cekur më lartë, ku i dëmtuari ishte duke shërbyer, i pandehuri pas fjalosjes verbale, duke dalur nga restoranti e godet të dëmtuarin me grusht në veshin e majtë dhe në krahun e djathtë, ku si pasojë e goditjeve i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin, të konstatuar sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. B. C. të datës 31.10.2018.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë

në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është baba i 2 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, premtimin se nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga i dëmtuari, pendimin e shprehur për veprën e kryer, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, e të gjitha këto ndikuan që Gjykata të akuzuarit ti shqiptoj dënim me burgim kohëzgjatje **prej 4(katër) muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer, shkallen e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr. 814/18 më datë 06.05.2019**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.